



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**TIRANE**

---

**Nr. 647 REGJ.THEM**

**V E N D I M**

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e përbërë nga;

**GJYQTAR : REGLETA PANAJOTI**

asistuar nga sekretare gjyqësore **Elona Vorpsi**, me prezencën e organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqesor Tiranë përfaqësuar nga prokurori z.**Hysni Mulaj**, në seancë gjyqësore me detyrë të hapura, sot më datë 08.06.2010 shpall këtë vendim lidhur me kërkesën penale që i përket :

**KERKUES :**            **A.K** i biri i (.....) dhe i (.....),  
dtl.(.....), lindur dhe banues në Tiranë, me adresë  
Rr".....", Pall....., Shk....., Ap....., me  
kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbrojtur nga Av.Ajsela  
Beqaj, e pajisur me prokurorë të posaçme, me Nr.2405 Rep  
dhe Nr.494/1 Kol, dt.25.05.2010.

**OBJEKTI :**            "Kundershtim i procesverbalit të sekuestrimit të datë  
23.02.2009, të Oficerit të Policisë Gjyqësore si i  
paperdorshem".  
Lenien e automjetit tip veturë markë "HONDA CIVIC"  
me Nr.Shasie (.....)me targë(.....),  
në ruajtje të kerkuesit.

**BAZA LIGJORE:**    Neni 214/1, 300/2, 301/1/2, 151/4 i K.Pr.Penale.

Në pretendimet përfundimtare avokati i kerkuesit kërkoj :

1.Deklarimin e paperdorshem të proces- verbalit të policisë gjyqësore për sekuestrimin e provës materiale të datës 23.02.2009 për automjetin tip Honda Civic me targë (.....) me Nr shasie (.....)me ngjyre Gri si dhe dokumentacionin.

2. Kthimin dhe lenien në ruajtje të kerkuesit të sendeve të sekuestruara.

Përfaqësuesi i Prokurorisë kërkoj mospranimin e kërkesës .

Gjykata, pasi degjoi pretendimet e paleve si shqyrtoi provat dhe diskutoi ceshtjen ne teresi

### VEREN

Se kerkuesi A.K i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me nje kerkese duke pretenduar se i duhet kthyer automjeti tip Honda Civic me targa (.....)me Nr shasie (.....), si dhe i gjithë dokumentacioni, si posedues me mirbesim dhe se procesverbali me te cilin eshte sekuestruar ky automjet eshte i paperdorshme.

Nga hetimi gjyqesor rezultoi se :

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi bazën e materialit të dërguar nga ana e DPQ-Tiranë,“Seksioni kundër trafikëve të paligjshme” ka rregjistruar procedimin penal nr. 1299 viti 2009, për veprën penale të “Trafikim të mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/a të K.Penal .

Nga hetimet deri në këtë fazë ka rezultuar se në dt 23.02.2009 nga ana e policisë gjyqësore është bërë sekuestrimi i automjetit tip Honda Civic me targa (.....) me Nr shasie (.....) si dhe i gjithë dokumentacioni shoqerues, pasi nga verifikimet e kryera rezulton ky mjet te jete i vjedhur jashtë shtetit në Serbi me dt 6.06.2007 me targë origjine (.....). Nga verifikimi i bërë targës së sekuestruar me nr (.....), rezulton se kjo targë i përket mjetit tip Mercedes Benz 320- me nr shasie (.....)I i cili rezulton të jetë kallëzuar si i vjedhur jashtë shtetit në Itali me dt 24.11.2007.

Nga shqyrtimi ne seance gjyqesore i akteve qe i perkasin fashikullit te procedimit te mesiperm rezulton se nuk ka asnje vendim te prokurorit per vlefesimin e procesverbalit te sekuestrimit të dt 23.02.2009, mbi sekuestron e mjetit Honda Civic me targa (.....) me Nr shasie (.....)si dhe të gjithë dokumentacionit të mjetit te sekuestruar me kete procesverbal.

Sic permendem me sipër, automjeti dhe dokumentacioni i tij jane sekuestruar nga policia gjyqesore pa patur autorizimin perkates nga prokuroria apo gjykata.

Duke qene keshtu, meqenese ky veprim nuk eshte deleguar nga prokuroria apo Gjykata, nuk mund te zbatohet neni 208 i K.Pr.Penale, por ( ne interpretimin me te favorshme per policine) ndodhemi para parashikimeve te nenit 301 te ketij kodi kur policia gjyqesore vepron me iniciativen e saj

Në rastin objekt gjykimi, veprimi për sekuestrimin e automjetit dhe dokumentacionit shoqërues është veprim i kryer me initiative të policisë gjyqësore dhe duhet trajtuar ne baze te nenit 293 dhe vijues te K.Pr.Penale.

Nga fashikulli i prokurorise deri në këtë fazë të hetimit ( fotokopje e të cilit u administrua në dosjen gjyqësore), rezulton se organi i prokurorise nuk eshte shprehur lidhur me sekuestron e vendosur nga policia gjyqesore as per vleresimin e sekuestros dhe as per kthimin e sendeve.

Lidhur me sa më sipër, Gjykata verën se :

1. neni 190 i K.Pr.Penale parashikon detyrimin e Gjykatës për të disponuar në vendimin e saj përfundimtar, për provat e sekuestruara për llogari të procedimit penal, që është gjykuar nga kjo Gjykatë.
2. Neni 208 “**Objekti i sekuestrimit**” parashikon se: “1. Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. 2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim 3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, nëse është i pranishëm”.
3. Neni 217 i K.Pr.Penale “**Kthimi i sendeve të sekuestruara**” parashikon se : “1. **Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë** edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyer. 2. Gjykata mund të disponojë që kthimi i sendeve të mos bëhet kur, me kërkesën e prokurorit ose të paditësit civil, duhet të mbahet sekuestrimi për të siguruar padinë civile. 3. Pasi vendimi merr formë të prerë, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë, përveç rasteve kur vendoset konfiskimi.”
4. Neni 301 i K.Pr.Penale, si një nga nenet e Kreut IV “ Veprimtaria me iniciative e policisë gjyqësore” parashikon se “1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja. 2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë **brenda dhjetë ditëve** nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t’i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros.”

**Së pari** .Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme rezulton se, provat materiale (sende, të holla, dokumente shkresore, etj..) që të konsiderohen të sekuestruara në kuptim të ligjit procedural penal, duhet që fakti i sekuestrimit të tyre të pasqyrohet në një akt procedural, në rastin konkret vendim të arsyetuar të gjyqtarit, prokurorit apo OPGj i deleguar nga prokurori.

Në rastin objekt të gjykimit rezultoi se ekziston një procesverbal sekuestrimi i dt 23.02.2009, por nuk rezultoi që procesverbali i sekuestrimit të OPGJ te jete vleresuar brenda afateve ligjore të parashikuara në dispozitat e sipërcituara.

Mosvleftësimi ose vleftësimi me vonesë i procesverbaleve të sekuestros përbën në vetvete shkelje, por jo shkak për pavlefshmërinë e aktit. Keto veprime sjellin si pasojë papërdorshmerine e tij ne momentin e gjykimit te ceshtjes por jo pavlefshmerine e tij .

**Së dyti** - Gjykata analizon edhe kerkimin e dYTE te parashtruar ne objekt lidhur me kthimin e sendit tek kerkuesi A.K .

Lidhur me këtë kërkim Gjykata vëren se kërkuesi është në këtë gjykim me cilësin e personit te cilit i janë sekuestruar sendet. Në këtë kontekst ai në vështrim te ligjit legjitimohet te kundershtoje procesverbalin e sekuestrimi, por ai nuk mund te legjitimohet te kerkoje kthimin e sendeve dhe lenien e tyre ne ruajtje përsa kohe që nuk provon dot titullin mbi sendin e sekuestruar. Ai nuk arriti te provoje cili është tagri i tij mbi sendet e sekuestruar, ai nuk është në kushtet e pronarit te sendeve te sekuestruara, nuk është ne kushtet

e poseduesit te ligjshem pasi nuk provon dot aktin e lëshuar nga pronari i ligjshem ne bazë të të cilit ai ka qënë në posedim te sendit në momentin e sekuestrimit te tij .

Në këto kushte ai është ne kushtet e poseduesit të paligjshëm. Këkuesi nuk mund te konsiderohet ne kushtet e poseduesit me mirbesim dhe si i tille nuk mund te legjitimohet te vendoset ne posedim pa titull mbi sendin e sekuestruar.

Këtë ka mbajtur parasysh edhe ligjvënësi kur ka rregulluar ne nenin 217 të K.Pr.Penale faktin se kujt i kthehen sendet e sekuestruara në termat që këto sende i kthehen *personit që i takojnë* .

**Së treti** -Gjykata konstaton gjithashtu se ankimi ne Gjykatë është realizuar tej afatit ligjor prej 10 (dhjete) ditësh që ka rregulluar neni 301 i K.Pr.Penale .

**Së katërti** - gjykata cmon gjithashtu se sendi i sekuestruar nuk duhet ti kthehet kërkuesit edhe për faktin se ky send mund të përdoret për qëllim prove përsa kohe që ai është produkt i një vepre penale dhe ende nuk janë marrë të gjitha provat që konkretisht kanë të bëjnë me ekspertimin e numrit të shasisë së sendit te sekuestruar, ( fakt i cili është pretenduar si shkak i shtyrjes së afatit te hetimeve në sygjerimin e OPGJ të dt 15.12.2009) .

Në konkluzion për të gjitha shkaqet e analizuara më lart kërkesa nuk duhet të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata krijoi bindjen dhe bazuar ne nenin 190 e 217 te K.Pr.Penale:

### **VENDOSI**

-Rrezimin e kërkesës penale me Nr. 647 Akti, me kerkues **A.K.**

-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuesit.

-Kunder këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

-U shpall sot, në Tiranë më datë 8 Qershor 2010.

**SEKRETARE**

**ELONA VORPSI**

**GJYQTAR**

**REGLETA PANAJOTI**

